



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 741/1 Prishtinë 14.03. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Endrit Pepaj** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “**Percaktimi i modulit të elasticitetit për klasa të ndryshme të betonit**” në programin e studimeve Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Në shkencat e inxhinierisë së ndërtimit moduli i elasticitetit si veti deformabile është shumë i rëndësishëm dhe ndërlidhet me sjelljen e strukturës nën veprimin e ngarkesave. Të gjitha materialet kanë sjellje të ndryshme dhe posedojnë veti të ndryshme deformabile, e me këtë ky parameter është tregues dhe i lidhur me vetitë mekanike për materiale të ndryshme e sidomos me procesin e ngarkim shkarkimit gjegjësisht ngarkesat ciklike.

Me zhvillimin e teorive dhe teknologjisë së materialeve ky parameter ka edhe më shumë një gjithëpërfshirje dhe ndërlidhje në përdorimin e materialeve të ndryshme në kuadër të strukturas, ngase betoni si material është më i përhapur në inxhinierinë e ndërtimit, atëhere përcaktimi i modulit të elasticitetit është një sfidë e vecant ngase vetitë mekanike janë në funksion të rritjes së ngurtësimit të betonit, ku si parametër është betoni i ngurtësuar pas periudhës së ngurtësimit prej 28 ditësh.

Projektimi i strukturave kërkon lloje dhe klasa të ndryshme të betonit, prandaj që të jemi afër realitetit dhe duke përvetësuar se moduli i elasticitetit për klasë të ndryshme është variabile atëhere përcaktimi në mënyrë eksperimentale mund të na sjell deri tek vlerat që të kemi një krahasim me analizën analitike për standardet EC dhe ACI.

Fjalët kryesore: Moduli elasticitetit të betonit, strukturat e betonit, materialet e ndërtimit, testimi i mostrave të betonit etj.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.